

UNITED NATIONS
United Nations Interim
Administration Mission in
Kosovo



UNMIK

NATIONS UNIES
Mission d'Administration
Intérimaire des Nations Unies au
Kosovo

UNMIK/DIR/2000/19

21 gusht 2000

URDHËRESË ADMINISTRATIVE NR. 2000/19

**NDRYSHIMI I URDHËRESËS ADMINISTRATIVE TË UNMIK-ut NR. 2000/1
MBI ZBATIMIN E RREGULLORES SË UNMIK-ut NR. 2000/2 PËR
AKCIZAT TË DATËS 22 JANAR 2000,**

Përfaqësuesi Special i Sekretarit të Përgjithshëm,

Në pajtim me autorizimet që i janë dhënë me Rregulloren Nr. 2000/2 të Misionit të Administratës së Përkohshme të Kombeve të Bashkuara në Kosovë (UNMIK) për tatimin e akcizave në Kosovë të datës 22 janar 2000,

Pasi që e ka nxjerrë Urdhëresën administrative të UNMIK-ut nr. 2000/1 për zbatimin e Rregullores së UNMIK-ut nr.2000/2,

Me qëllim të përmirësimit të mëtejshëm të efikasitetit të tatimeve të akcizave në Kosovë,

Nëpërmjet kësaj e ndryshon nenin 1 të urdhëresës administrative të UNMIK-ut nr. 2000/1.

Prandaj, prej datës kur kjo Urdhëresë administrative hyn në fuqi, urdhëresa administrative do të jetë e formuluar si vijon:

URDHËRESË ADMINISTRATIVE NR. 2000/1

**MBI ZBATIMIN E RREGULLORES SË UNMIK-ut NR. 2000/2 PËR
TATIMET A AKCIZAVE NË KOSOVË TË DATËS 22 JANAR 2000**

Përfaqësuesi Special i Sekretarit të Përgjithshëm,

Në pajtim me autorizimet që i janë dhënë me Rregulloren e UNMIK-ut nr. 2000/2 për tatimin e akcizave në Kosovë të datës 22 janar 2000,

Nëpërmjet kësaj e lëshon Urdhëresën administrative në vijim:

Neni 1 Përrjashtimet

1.1 Tatimi i akcizave nuk do të vëhet në artikujt vijues:

(a) Në materialet e papërpunuara dhe ndihmëse, që përndryshe do t'iu nënshtroheshin tatimeve të akcizave, të importuara në Kosovë nga njerëzit që e kanë lejen e lëshuar nga Shërbimi Doganor i UNMIK-ut përmes të cilit autorizohen importimet e tilla në rastet kur materialet e tilla duhet të përdoren për prodhimin e mallrave për eksport;

(b) Në mallra, për të cilat drejtori i përgjithshëm i Shërbimit Doganor të UNMIK-ut vendos se do të përdoren vetëm për qëllime humanitare dhe nuk do të ofrohen për shitje të konsumimit në Kosovë;

(c) Në mallrat e financuara nga të ardhurat e granteve që i jepën UNMIK-ut nga qeveritë, agjencitë qeveritare, organizatat qeveritare dhe joqeveritare për t'i përkrahur programet dhe projektet humanitare dhe të rindërtimit në Kosovë dhe

(ç) Në mallrat e tjera të përcaktuara nga Përfaqësuesi Special i Sekretarit të Përgjithshëm që të përrjashtohen nga tatimi i paraparë në këtë urdhëresë administrative, që do t'iu nënshtrohen kushteve të volitshme të përcaktuara nga ai/ajo.

1.2 Tatimet e akcizave nuk do t'i paguajnë organet në vijim:

(a) Misionet e huaja diplomatike dhe konsullare;

(b) Kombet e Bashkuara ose çdo nga organi e saj duke e përfshirë UNMIK-un, agjencitë e Kombeve të Bashkuara, KFOR-in, organizatat ndërkombëtare ndërqeveritare dhe agjencitë qeveritare për mallrat që shfrytëzohen për qëllime zyrtare;

(c) Kontraktuesit e UNMIK-ut, agjencitë e specializuara të Kombeve të Bashkuara dhe të KFOR-it që importojnë mallra të cilat përdoren vetëm nga ata për të përmbushur kontratat e UNMIK-ut, agjencive të specializuara të Kombeve të Bashkuara ose të KFOR-it;

(ç) Organizatat e regjistruara joqeveritare me status të beneficuar publik siq është përkufizuar në Rregulloren e UNMIK-ut nr. 1999/22 të datës 15 nëntor 1999 për mallrat në vijim që përdoren vetëm nga organizatat joqeveritare për t'i plotësuar qëllimet e tyre të dobisë shoqërore: benzinë, kerozinë, naftë, etanol, telefona mobilë, antena satelitore, televizorë dhe videorekorderë dhe

(d) Organizatat ose subjektet e tjera të përcaktuara nga Përfaqësuesi Special i Sekretarit të Përgjithshëm që të përrjashtohen nga tatimi i paraparë në këtë urdhëresë administrative për t'iu nënshtrohen kushteve të volitshme të përcaktuara nga ai/ajo.

Neni 2
Mbledhja

Tatimet e akcizave do të caktohen, vëhen dhe mblidhen si vijon:

(a) Për mallrat e importuara: në vendkalimet kufitare ndërkombëtare të autorizuar dhe në depot vendore të zhdoganimit dhe

(b) Për mallrat e tjera që hyjnë në Kosovë ose mallrat që prodhohen në Kosovë: në zyrat për mbledhjen e tatimit të akcizave dhe në vendet e prodhimit.

Neni 3
Procedurat dhe kundërvajtjet

Udhëzimet për procedurat dhe kundërvajtjet e tatimit të akcizave do të jepen në pajtim me ligjin e aplikueshëm.

Neni 4
Hyrja në fuqi

Kjo Urdhëresë administrative¹ hyn në fuqi më 22 janar të vitit 2000.

Kjo Urdhëresë administrative hyn në fuqi më 21 gusht të vitit 2000.

Bernard Kouchner
Përfaqësues Special i Sekretarit të Përgjithshëm

¹ Urdhëresa origjinale administrative